



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



Datë: 21.03.2025
Nr.09/ 1975 /2025

KONTRATË PËR FURNIZIM

Numri i kontratës ¹: 659-25-619-1-3-6/C616: KKHE-25-001-1-3-6

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe
EUROPRINT GROUP SH.P.K., Kompleksi Banesor A1 Lagja Emshir Prishtinë, Prishtinë, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Furnizim me pajisje të IT-se (TV) me numër identifikues: 659-25-619-1-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
1	Furnizim me pajisje të IT-se (TV)

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 30 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë .

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë .

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 1,198.00 €; [Njëmijë e Njëqindë e Nëntëdhjetë e Tetë] Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtrohen ndryshimeve]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: [shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;
- (f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet


6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të ceken titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	KHEVOGT BUSHI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	21.03.2025
Vula:	

Për Furnizuesin

Emri:	Mengim Allani
Pozita:	Përfshues Ligjor
Nënshkrimi:	
Data:	21.03.2025
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-25-619-1-3-6/C616: KKHE-25-001-1-3-6

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE.
Siguria e ekzekutimit	9.1	Sigurimi i ekzekutimit 10% e vleres së kontratës + 30 dite pas afatit të perfundimit
Sigurimi	10.1	[Specifikoni kërkesat specifike të sigurimit]
Programi i ekzekutimit	11	Ekzekutimi do të bëhet konform produkteve të prezantuara në dosje konform specifikave të kërkuara
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	Të gjitha tatimet janë përgjegjësi e Operatorit ekonomik.
Patentat dhe licencat	13.1	[Specifikoni nëse ka ndonjë shmangie nga Neni 13 i KPK]
Cilësia e furnizimeve	18.2	Furnizimet do të jenë konform specifikave.
Inspektimi dhe testimi	19.2	Inspektimi dhe testimi do të bëhet nga komisioni në momentin e pranimit
Pagesa	20.1	Pagesa do të bëhet brenda 30 dite nga momenti i pranimit të furnizimit dhe fatures.
Dorëzimi	21.3	Sipas specifikave të kërkuara në dosje
Obligimet e garancionit	24.1	Sipas kërkesës në dosje, produktet kanë garancion 4 vite apo 48 muaj nga momenti i pranimit. Prandaj, duhet të deshmohet me fletgarancion për 4 vite. Në rast se ndodhin defekte në produktet e pranuar, do të njoftohet OE për defektet dhe ka afat 7 dite për të bërë rregullimin/servisimin e pajisjeve dhe ti kthen në komunë. Në rast se nuk servisohen duhet të sjellen te reja në rast se ndodh defekti brenda periudhës së garancionit.
	24.5	[Specifikoni ndonjë obligim shtesë sipas garancisë]
Shërbimet pas shitjes	25.1	Garancioni 4 vite ose 48 muaj
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Mosmarrëveshjet zgjidhen në frymën e mirekuptimit në mes të menaxherit dhe kontraktuesit. Në rast se nuk ka marrëveshje në frymën e mirekuptimit do të bëhen zgjidhje përmes gjykates.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me	32.1	[shëno te dyja]
		a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë

procedure gjyqësore	ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>Gjykata Komerciale – Prishtinë</i> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].
---------------------	--